



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.587/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues dhe Faton Ademi dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Jetmir Velijaj me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me ndërrimin e vendbanimit në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** i palejuar apeli Anr.587/2021, i paraqitur nga Jetmir Velijaj me vendbanim në Zvicër me të cilin kërkon ndërrimin e vendbanimit në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Jetmir Velijaj me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se ka aplikuar, për regjistrim si votues jashtë Kosove, me vendbanim në Komunën e Junikut dhe se në listën e publikuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, emri i figuron në listë si votuese jashtë Kosovës për Komunën e Deçanit, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 17 Tetor 2021.

Parashtruesi i apelit, ka bashkangjitur emailin nga KQZ, formularin e aplikimit, dokumentin identifikues/ pasaportë si dhe Ekstraktin nga Regjistri Qendror i gjendjes Civile.

Me datë 01.09.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje në KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese, KQZ brenda afatit kohor është përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se Jetmir Velijaj, me numër të regjistrimi të KQZ-së 2021171023040, është votues në listën e votuesve jashtë Kosovës. Emri i tij figuron në faqen numër 37 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës, që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-së.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Parashtruesit të Apelit i mungon interesi juridik**

Me datë 01.09.2021 Jetmir Velijaj PZAP, ka parashtruar në apel ndaj KQZ-së, me të cilin kërkon ndërrimin e vendbanimit në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ-së, palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ-së, për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.


KQZ-ja, me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve meqenëse i njëjti i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë.

PZAP, duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjti është i përfshirë në listën e votuesve. Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi Jetmir Velijaj gjendet në listën votuese.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.587/2021 më datën 02.09.2021



**Kryesuesi i Panelit**

Adnan Konushevc

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.